

LLOJET E PUNIMEVE PA DEKLARATË PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH.

- Në **VKM Nr. 408, Datë 13.5.2015**, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar me **VKM nr. 271, datë 06.04.2016**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar” **VKM nr. 231, datë 21.03.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar” dhe **VKM Nr. 355, datë 19.04.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, Neni 6, përcakton llojet e punimeve për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi apo Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh, të cilat janë:

1. Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme:

a. Ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si më poshtë vijon:

- i. rifreskimi i lyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese;*
- ii. pastrimi i fasadave;*
- iii. riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si, forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;*
- iv. zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;*
- v. riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve e oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme;*
- vi. riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;*
- vii. vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;*
- viii. vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;*
- ix. sistemimi i oborreve;*

x. *riparimi i rrethimeve ekzistuese.*

b. Ndërrhyrje të brendshme:

i. *riparimi dhe rinovimi i dyshemeve;*

ii. *riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;*

iii. *riparimi dhe rinovimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave.*

c. Ndërrhyrje në impiante higjieno-sanitare:

i. *veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit;*

2. Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara.

3. Lëvizjet e dheut që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërrhyrjet në impiante hidraulike bujqësore.